




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.11, datë 08.05.2023



PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “CLAUBEL” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Claubel”, sipas Kontratës me Nr. 1485 Rep., Nr. 961/1 Kol., datë 4.7.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Bletëza” me kapacitet prodhues 1950 MW” me vendndodhje në ujërat e lumit Devoll, degë e lumit Seman, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Bletëza

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Lumi Devoll

- X= 522799; Y= 4516900; Z=277 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 30 m³/s



- Prurja mesatare vjetore: 27.3 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 3.608 m³/s
- Prurja ekologjike: 1.2 m³/s

Vendndodhja e godinës së centralit

- X= 521486; Y=4517830; Z=257 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 30 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 8.503.916 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 1950 kwh
- Vlera totale e investimit: 516,520,689 lekë.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HFC-it Bletëza takon trupin uJOR pritës.

- X= 521501; Y= 4517815; Z=257 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

